

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Mobileri Lura 1

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 01.11.2025 sipas kerkesave te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite trgetare” dhe te ligjit nr.9723 date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit,i perditesuar krijohet shoqeria tregtare **Mobileri Lura 1** e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, nenet e ketij statuti si dhe aktit bashkengjitur tij.

KREU II

EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqeria tregetare e emertuar **Mobileri Lura 1** sh.p.k. me themelues;

Ilirjan Kaci, i datelindjes 18.06.1969 , i pajisur me id.G90618087F

NENI 3

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 4

- **Selia e shoqerise tregetare private Mobileri Lura 1 do te jete ne adresen: 1**
Kamez, Paskuqan, Njesia Administrative Paskuqan 2, Rruga Korabi, Ndertese 1 kateshe, nr.58
- Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjensi operative ne te gjithe territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 5

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

NENI 6

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje **Mobileri Lura 1**

KREU III

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 7

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Marangoz, punime mobilerie, tregti artikuj te ndryshem mobilerie.

KAPITALI

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke, i ndare ne 1 kuote, dhe zotërohet si me poshte:

Ilirjan Kaci zoterues i 1 kuote qe perben 100% te kapitalit e barazavlefshme me 100.000 lek.

Kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 9

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakut te vetem, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 10

Ortakët mund t'u shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi tua kene ofruar per blerje ortakut brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te treteve. Oferta i komunikohet me shkrim ortakut te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

NENI 11

Kapitali shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejteshme e te paluejteshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 12

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.

KREU IV

ORGANET DREJTUESE

NENI 13

Organi drejtues i shoqerise eshte;

Ilirjan Kaci, zoterues i 1 kuote qe perben 100% te kapitalit e barazavlefshme me 100.000 lek.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte:

ASAMBLEJA

NENI 14

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor. Ajo mblidhet sa here e shohin te arsyeshme ortakët, por domosdoshmerisht per te miratuar bilancin vjetor te shoqerise. Asambleja i merr vendimet e ortakeve , pervec rasteve te parashikuara ne statut.

NENI 15

Asambleja vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, shtimin ose pakesimin e kapitalit, per emerimin e organit administrativ, per drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 16

Administrator i shoqerise Mobileri Lura 1 do te jete :

Ilirjan Kaci me afat 5 vjecar.

NENI 17

Administratori ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 6 te ketij statuti.

Organi Administrativ eshte kompetent per :

- te miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturen e aparatit te shoqerise;
- marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e mardhenieve te punes me ta;
- propozon rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta), ndarjen e fitimit, etj. ;
- perfaqesuar apo emeruar perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria;
- perfaqesuar shoqerine ne regjistrin e prones sipas nenit 20 te ketij statuti.

KREU V

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 18

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

NENI 19

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kriterëve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

NENI 20

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne organet tatimore, ndersa vitete tjera ne Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo vit. Ne cdo fund periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes nxirret bilanci. Bilancet periodike (mujore, tremujore e gjashtemujore) miratohen e nenshkruhen nga Administratori e me pas ratifikohen ne asamblene e radhes. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nenshkruhen nga administratoret.

NENI 21

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise,mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i rezerves ligjore, sipas vendimeve te asamblese.

KREU VI

MAREDHENIET E PUNES

NENI 22

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne to zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne R.Sh. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj , nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

KREU VII

NENI 23

Veprimtaria e shoqerise pushon me vendim te asamblese per shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakut te vetem
- riorganizohet ne nje forme tjeter

NENI 24

Ne kushtet e nenit 23 te ketij statuti asambleja cakton nje ose me shume likujdatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer gjithë veprimet e likuidimit te saj, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakut, ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit ortaku eshte i detyruar te derdhi kuotat e tyre deri ne nivelin e kuotave te kapitalit themeltar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane.

NENI 26

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje asambleja si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxiret vete statuti.

NENI 27

Ky statut u perpilua ne prani te ortakut duke shprehur vullnetin e tij te lire. Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit Tirane, ne zyren e Tatim -Taksave dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

O R T A K U

I

THEMELIMIT TE SHOQERISE

Mobileri Lura 1

Ilirjan Kaci

,